



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 25.04.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-7819, të datës 31.01.2019

Neni 1.

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimi, 01-Nr-016-7819 i datës 31.01.2019 për formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës, me qëllim të kompensimit të anëtarëve të komisionit të lartcekur.

Neni 2.

Pas nenit 2, të Vendimit bazik 01-Nr-016-7819 i datës 31.01.2019 për formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës, shtohet një nen i ri, me tekstin në vijim;

Neni 2 A

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës, konkretisht të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 2 B

Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-7819, të datës 31.01.2019, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-27908
Më datë 25.04.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI